



# **RAPORT PËRMBLEDHËS**

## **I AKTIVITETEVE TË PLATFORMA CIVIKOS**

### **2019**



Janar 2020





**RAPORT PËRMBLEDHËS**  
**I AKTIVITETEVE TË PLATFORMA CIVIKOS**  
**2019**



# Përmbajtja

7	HYRJE
8	PLATFORMA CIVIKOS
8	DONATORËT
8	LISTA E AKRONIMEVE
9	ANËTARËSIA
9	BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE – QEVERI
9	Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023
11	Takimet e Këshillit dhe anëtarëve të grupeve punuese gjatë vitit 2019
12	MASAT NË PARANDALIMIN E SHPËLARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE NDIKIMI NË PUNËN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE
12	Punëtori me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë
13	Dialogu shumë-palësh në qasjen e OJQ-ve në Shërbime Financiare: Tryezë e organizuar nga CiviKos dhe KCSF me mbështetje të ECNL
13	Diskutimet dhe Rekomandimet kryesore
15	NGRITJA E KAPACITETEVE TË ORGANIZATAVE LOKALE NË MONITORIM TË PROKURIMIT PUBLIK



Të nderuara organizata anëtare të Platforma CiviKos,

Nga emërimi im si Drejtoreshë e Platformës CiviKos në korrik të vitit 2019, Kosova ka kaluar nëpër një periudhë të gjatë elektorale e cila pati ndikim shumë të madh në funksionimin e brendshëm dhe të jashtëm të vendit.

Shpallja e zgjedhjeve të parakohshme dhe periudha konsiderueshëm e gjatë e udhëheqjes së Shtetit nga Qeveria në ikje, kanë ndikuar shumë në punën e sektorit të Shoqërisë Civile në Kosovë. Kjo zbrazëti institucionale ka ndikuar negativisht në punën e secilës organizatë, sidomos ka ndikuar shumë në punën e CiviKos si rrjet i organizatave të shoqërisë civile që lehtëson bashkëpunimin në mes të atyre organizatave civile dhe institucioneve publike.

Megjithatë, CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kanë ndërvepruar për të krijuar kushte të favorshme për zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqëri Civile (2019 – 2023) e lansuar në muajin Prill të 2019. Strategjia u përpilua në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, proces ky i mbështetur nga CiviKos. Gjatë këtij viti, CiviKos ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë. Operacionalizimi i Këshillit të ri ka qenë një proces tepër sfidues duke qenë se është zhvilluar në rrethana të jashtëzakonshme.


Puna e Këshillit për zbatim të Strategjisë dhe ekipeve punuese do të kenë përsëri katër objektiva si vijon: 1) Rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në bërjen e politikave; 2) Rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në financimin publik për shoqërinë civile; 3) Zhvillimin e praktikave dhe procedurave për kontraktimin e Shoqërisë Civile për ofrimin e shërbimeve publike; dhe 4) Nxitjen dhe promovimin e vullnetarizmit në programet më interes publik.

Aktivitetet tjera të CiviKos që kanë për qëllim përmirësimin e ambientit për funksionim të Shoqërisë Civile në Kosovë, përfshijnë ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe ndikimi i tyre në OJQ-të e regjistruara në Kosovë. CiviKos bashkë me organizatat anëtare janë duke punuar në mënyre proaktive për të adresuar shqetësimet e organizatave të Shoqërisë Civile dhe trajtimi i tyre nga Bankat komerciale në Kosovë.

CiviKos ka vazhduar punën me organizatat anëtare të cilat operojnë në rajone të ndryshme të Kosovës. Në bashkëpunim me USAID, CiviKos ka kontribuar në fuqizimin e Shoqërisë Civile në nivel lokal. Shumë organizata të Shoqërisë Civile nuk janë në gjendje të kryejnë monitorim të plotë të prokurimit për shkak të mungesës së aftësive, kapaciteteve dhe financimit. USAID përmes DAI TEAM dhe CiviKos është duke punuar për të pajisur organizatat e Shoqërisë Civile të nivelit lokal me aftësitë praktike të nevojshme, për të ndryshuar këtë realitet. Puna e CiviKos me organizatat anëtare do të vazhdojë edhe në kuadër të projekteve të tjera deri në përmbushje të objektivave të Strategjisë së CiviKos dhe misionit në bazë të së cilit u ndërtua kjo platformë.

Ky vit do të jetë vit i rivitalizimit të CiviKos si platforma më e madhe në vend për Shoqërinë Civile. Ne do të punojmë me përkushtim për të krijuar ambient të favorshëm për Shoqërinë Civile, për të rrjetëzuar organizatat jo-qeveritare dhe Qeverinë me qytetarët. Ky vit do të jetë viti i ndërtimit të konstituencave dhe vit i afrimit të organizatave të Shoqërisë Civile me qytetarin.

Në përmbyllje, po e shfrytëzoj mundësinë që përmes kësaj letre, të ju falenderoj për mbështetje të CiviKos-it dhe besimit në mua si drejtuese e sekretariatit. Falenderoj ekipin tim që më kanë mbështetur në çdo hap që nga dita e parë e punës.

  
 Shqërisht,  
 Donika EMINI

## PLATFORMA CIVIKOS

Platforma CiviKos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Që nga themelimi i saj Platforma CiviKos ka qenë e angazhuar që të jetë zë i fuqishëm i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, duke krijuar një ambient sa më të favorshëm të bashkëpunimit shoqëri civile - qeveri. Aktualisht CiviKos ka 254 organizata anëtare.

## DONATORËT

CiviKos gjatë 2019 është mbështetur financiarisht nga:

- Ambasada e Mbretërisë së Holandës - MATRA.
- USAID /Komunat Transparente Efektive dhe Llogaridhënëse, ku CiviKos është nënkontraktor i kompanisë implementuese DAI.
- European Center for Not-for-Profit Law - ECNL


## LISTA E AKRONIMEVE

<b>CiviKos</b>	Platforma CiviKos
<b>OSHC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>KCSF</b>	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
<b>KFOS</b>	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>Strategjia Qeveritare</b>	Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023
<b>Këshilli</b>	Këshilli për Bashkëpunim shoqëri civile qeveri
<b>TEAM</b>	Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse



## ANËTARËSIA

- 254 organizata anëtare në CiviKos;
- 26 organizata të anëtarësuara gjatë vitit 2019
- CiviKos gjatë vitit 2019 ka dërguar 80 buletine javore tek organizatat anëtare me informata relevante për shoqëri civile si mundësi për grante, konferenca dhe informata tjera relevante.



Shifra në secilën shtyllë tregon numrin e organizatave anëtare të regjistruara deri në fund të vitit.

## BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE – QEVERI

### Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

- Më 4 Prill 2019 në ambientet e Qeverisë të Kosovës u lansua Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Konferenca e lansimit të Strategjisë u organizua nga Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të BE-së dhe Platformës CiviKos si partner kryesor në procesin e bashkëpunimit të strukturuar shoqëri civile-qeveri. Në lansim të Strategjisë, përveç anëtareve të shoqërisë civile të pranishëm ishin edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës Z.Ramush Haradinaj dhe shefja e zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë Znj.Natalya Apostolova.



- Maj 2019 - CiviKos së bashku me ZQM përmes procedurave të hapura dhe demokratike kanë lehtësuar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillën për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri.



## Anëtarët e Këshillit

Pas përmbylljes së procesit të votimit, gjithsej kishin votuar 172 organizata, ku 164 prej tyre kanë votuar me email dhe 8 në zyrën e CiviKos.

Pas numërimit të votave nga 22 kandidatë, 14 anëtarët më të votuar të cilët u emëruan anëtarë të Këshillit janë:

- Abetare Gojani - [Ipko Foundation](#)
- Alutrim Dermaku - [General Youth Education of Kosovo-GYEK](#)
- Avdyll Gashi - [Qendra e Rinisë-Drenas](#)
- Besmir Kokollari - [Instituti për Hulumtime Analiza dhe Trajnime-ICHAT](#)
- Dajana Berisha - [Forumi Iniciativa Qytetare-FIQ](#)
- Dardan Qadraku - [Partners in Action- PACT](#)
- Dren Puka - [Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile- KCSEF](#)
- Ekrem Bajrami - Initiative for Kosova Community
- Jeton Krasniqi - Vizioni i Shekullit 21
- Lura Limani - [Fondi i Kosovës për Shoqëri të Hapur \(KFOS\)](#)
- Nertila Qarri - [Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës \(RrGK\)](#)
- Sadri Rrmoku - [Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale](#)
- Shemi Jashari - [Iniciativa për Ide dhe Alternativa](#)

Pas largimit të anëtares znj.Nertila Qarri nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, përmes procedurave të hapura është përzgjedhur anëtarja e re në Këshill nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës - znj.Nerina Guri.

## Takimet e Këshillit dhe anëtarëve të grupeve punuese gjatë vitit 2019

- 18 Korrik 2019: Pas konsolidimit të Këshillit, ZQM në bashkëpunim me CiviKos kanë organizuar takimin e parë të Këshillit për bashkëpunim shoqëri civile qeveri. Gjatë takimit u prezantuan anëtarët e Këshillit si dhe rregullat e punës të Këshillit.



- 16-17 Shtator 2019: ZQM/ZKM në bashkëpunim me CiviKos në mbështetje të projektit të asistencës teknike të zyrës së BE-së në Kosovë kanë organizuar punëtori me Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri. Gjatë kësaj punëtorie është hartuar plani i punës të Strategjisë për katër objektivat strategjike për vitin 2020.



- 9-10 Dhjetor 2019: ZQM në bashkëpunim me CiviKos organizon takimet e katër grupeve punuese të Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri. Gjatë takimit është finalizuar plani i punës për vitin 2020.





- 20 Dhjetor 2019: Është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit. Gjatë takimit u prezantuan të arriturat dhe sfidat në zbatim të Strategjisë. Po ashtu, u bë funksionalizimi i katër ekipeve të punës sipas katër objektivave strategjike të cilat do të punojnë në zbatim të aktiviteteve të Strategjisë të vendosura në planin e punës për vitin 2020.



## MASAT NË PARANDALIMIN E SHPËLARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE NDIKIMI NË PUNËN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

### Punëtori me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë

Më 28 Maj 2019, në sallën e konferencave ORION CiviKos së bashku me ECNL, kanë organizuar punëtori një ditore për tu njoftuar më shumë rreth proceseve të vlerësimit që Kosova është duke kaluar sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe ndikimi i tyre në OJQ-të e regjistruara në Kosovë.



Disa nga objektivat e punëtorisë ishin:

- Të njoftohen OJQ-të në Kosovë lidhur me Raportin e Vlerësimit, Ligjit të ri për OJQ dhe proceset tjera të lidhura me Parandalimin e shpëlarjës së parave dhe financimin e terrorizmit.
- Të njoftohen OJQ-të në Kosovë lidhur me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare përreth proceseve të ngjashme dhe si OJQ-të mund të angazhohen në parandalimin e masave kufizuese që çënojnë lirinë e asociimit;

- *Diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga Raporti i Vlerësimit dhe pajtimi lidhur me strategjinë për të siguruar se çfarëdo masash në të ardhmen janë në përputhje me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare;*
- *Të njoftohen OJQ-të në Kosovë lidhur me sfidat e de-rrezikimit bankar në Kosovë dhe globalisht, si dhe të diskutojmë se si ti trajtojmë ato.*

## **Dialogu shumë-palësh në qasjen e OJQ-ve në Shërbime Financiare: Tryezë e organizuar nga CiviKos dhe KCSF me mbështetje të ECNL**

Më 29 Tetor 2019, Platforma Civikos dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) kanë organizuar një takim të përbashkët midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve relevante publike për të diskutuar sfidat dhe problemet e OJQ-ve në qasjen në shërbime financiare. Kjo tryezë u organizua në bashkëpunim me European Center for Non Profit LAW (ECNL) me qendër në Holandë. Për më tepër, ekspertë nga Human Security Collective kanë ndarë praktikat e mira evropiane se si disa vende kanë adresuar probleme të ngjashme me të cilat OJQ-të janë ballafaquar në qasjen në shërbime financiare.



Qëllimi i këtij takimi ishte nxitja e dialogut ndërinstitucional midis përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, institucioneve përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve bankare dhe organizatave të shoqërisë civile në mënyrë që të diskutohen sfidat dhe problemet me të cilat OJQ-të përballën në qasjen në shërbimet financiare. Në të njëjtën kohë është diskutuar edhe për rrezikun e pastrimit të parave dhe financimin e mundshëm të terrorizmit në sektorin jo-qeveritar.

Kjo tryezë ka mbledhur zyrtarë nga Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike - Departamenti i OJQ-ve, Banka Qendrore e Kosovës - Divizioni kundër Pastrimit të Parave, Njësia e Inteligjencës Financiare, Shoqata e Bankave të Kosovës, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Kjo ngjarje shënon aktivitetin e dytë publik që ka organizuar CiviKos në këtë drejtim, ndërsa ngjarje të tjera avokimi do të organizohen për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për të lehtësuar qasjen e OJQ-ve në shërbime financiare

Pjesëmarrës në tryezë ishin përfaqësues të institucioneve si Ministria e Financave; Banka Qendrore e Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare, Shoqata e Bankave, si dhe përfaqësues të OJQ-ve në Kosovë.

### **Diskutimet dhe Rekomandimet Kryesore**

CiviKos ka prezantuar raportin e të gjeturave rreth problemeve që OJQ-të ballafaqohen me Bankat Komerciale në Kosovë. Raportin e plotë mund ta gjeni [këtu](#).

**Disa nga problemet e identifikuara nga raporti janë:**

- Disa banka komerciale kishin mbyllur llogaritë bankare të OJQ-ve pa paralajmërim, duke iu shkaktuar vështirësi në funksionimin e përgjithshëm.
- Bankat komerciale kanë një keqkuptim të përgjithshëm për strukturën drejtuese të OJQ-ve. Bankat insistojnë tek OJQ-të të sjellin themeluesit e OJQ-së në bankë për hapje të llogarisë bankare, apo gjatë procesit të përditësimit të dhënave, apo kërkojnë letërnjoftimet e tyre, edhe pse ata më nuk kanë rol udhëheqës në organizatë, duke mos i njohur strukturat tjera drejtuese si Bordi ose Kuvendi i Anëtarëve.
- Kërkesat për prezencë fizike të anëtarëve të bordit apo themeluesve në proces të përditësimit të dhënave.
- Rritjen e pagesë për mirëmbajtje të llogarive bankare vetëm për OJQ-të, në shuma të pa përballueshme për ato.

Disa nga përfaqësuesit e OJQ-ve prezente në takim, si: OJQ INPO, OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi, IKS, ATRC etj kanë ndarë përvojat e tyre rreth problemeve që OJQ-të (që ata i përfaqësojnë) kanë hasur me bankat komerciale.

**Disa nga problemet që këto OJQ ishin ballafaquar me bankat komerciale ishin:**

- Kërkesa për prezencë fizike të Anëtarëve të Bordit rreth përditësimit të informatave në bankë.
- Kërkesa për nënshkrime të themeluesve të bankës në procesin e përditësimit të informatave në bankë.
- Neglizhenca në përditësim të të dhënave dhe kontaktimi i drejtorëve të më hershëm të organizatës për të qenë prezent në bankë.

**Disa nga rekomandimet kryesore të këtij takimi ishin:**

- Bankat komerciale kanë nevojë për edukim financiar, në mënyrë që të kuptojnë më qartë natyrën dhe funksionimin e OJQ-ve.
- Nuk duhet të kërkohen themeluesit e organizatës qoftë për hapje të llogarisë, qoftë për përditësim nëse ata nuk kanë ndonjë rol udhëheqës në organizatë.
- Bankat duhet ti njohin organet vendimmarrëse në OJQ, siç janë: Kuvendi i Anëtarëve dhe Bordi.
- Pasi legjislativi që prek shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit është duke u rishikuar, të shfrytëzohet momenti që ti adresojmë të gjitha këto probleme përmes grupit punues që është themeluar nga Qeveria e Kosovës.



## NGRITJA E KAPACITETEVE TË ORGANIZATAVE LOKALE NË MONITORIM TË PROKURIMIT PUBLIK

### Punëtoritë mbi mësimin e aplikueshëm në kuadër të projektit Komunitat Transparente Efektive dhe Llogaridhënëse

CiviKos gjatë vitit 2019 ka organizuar punëtori mbi mësimin e aplikueshëm me organizata të shoqërisë civile në shtatë rajone të Kosovës. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte ngritja e kapaciteteve të organizatave lokale në monitorim të prokurimit publik përmes monitorimit të kontratave reale në komuna.



Grupi i organizatave të shoqërisë civile nga Komuna e Pejës.






Grupi i organizatave të shoqërisë civile nga Komuna e Prishtinës.



Grupi i organizatave të shoqërisë civile nga Komuna e Prizrenit.

Numri i pjesmarrësve në tre (3) punëtoritë e organizuara në disa qytete të Kosovës:

	Si të Monitoroni Prokurimin Publik	Si të përdorim Mediat për të Ekspozuar Korrupsionin	Punëtorit e Aplikimit të Mësimit
Ferizaj	25	17	5
Gjilan	17	13	6
Mitrovicë - Veri	14	10	5
Mitrovicë - Jug	19	16	7
Pejë	24	19	8
Prishtinë	18	16	6
Prizren	21	12	5



Tridhjetë e tre (33) **Organizata Jo-Qeveritare** janë përfshirë në serinë e punëtorive në kuadër të këtij projekti.



Janë publikuar shtatë (7) **Raporte të Monitorimit të Aktivitetit të Prokurimit** të hartuara nga Grupet Monitoruese të Organizatave Jo-Qeveritare.



platforma  
**CiviKos**

Raportet e hartuara nga Grupet Monitoruese të Organizatave Jo-Qeveritare, të cilët kanë përfituar dije dhe aftësi praktike përmes punëtorive për aplikimin e mësimit mbi monitorimin e prokurimit publik. Këto punëtori janë organizuar nga Platforma CiviKos në kuadër të aktivitetit të USAID Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM).

*Publikuar në vitin 2019*

